

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8JH-2

724

LONI PAPA



DRAME

Zbatharakët

SH-2

PL4

LONI PAPA

ZBATHARAKET

— dramë —



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

PERSONAZHET VEPRUES:

MARGA

MITI — *i biri.*

MARINA — *e mbesa, jetime.*

NERËNXA — *e shoqja e Mitit.*

PIRROJA — *punëtor rrugësh.*

KAPEDANI — *i shoqi i Margës.*

TODI — *shok i Kapedanit.*

DANI — *patriot i shtirur.*

PALI — *luftëtar.*

NDREU

KOLI *fshatarë dhe*

HILLI *më vonë punëtorë.*

LOLI

LAMI — *lypës*

LENA — *e shoqja e Todit.*

QEMALI — *beu.*

PRIFTI

ALDO — *komandanti fashist*

PËRFAQËSUESI

OFICERI

TELLALLI

*Fshatarë, fshatare,
një kapter, dordolecë etj.*

*Në karnavale lozin
tre aktorë:
Muço Damllaja,
Fauk Vrronja,
Llaz Leshi.*

KORI — përbëhet nga aktorët aktivë në skenë.

P J E S A E P A R Ë

PROLOGU

VEGIMI I MARGËS

(I shoqi në qeli, nga frëngjia e së cilës sheh trekëmbëshin në shesh.)

Shfaqja hapet me gongun e tellallit, zëri i të cilit tërheq vëmendjen e të burgosurve: «...Kush u shtron konak komitëve, do të kafshojë gjuhën në litar! Kush i dorëzon, do të hajë me lugë floriri!... Ej, millet!»

KAPEDANI — *(Merret me opingën)* Ia shkova dhe gjalmën. Tani është gati.

DANI — Kam parë në ëndërr, sikur haja pulë të pjekur. Kushedi ç'do të na ndodhë!

TODI — Ke për të kafshuar gjuhën në litar. Ja, kjo do të të ndodhë!

DANI — Kështu e ka kjo botë: kërko bukë e kafsho dhë! Kaq e patëm dhe ne!

KAPEDANI — Po ti pse dëshpërohesh?!

DANI — Më shkon mendja për të keq, Kapedan! Kur shoh nga frëngjia trekëmbëshin që ngritën sonte...

TODI — Atë nuk e ngritën për ty.

DANI — Për mua, a për Kapedanin...

KAPEDANI — Ashtu?! Unë nuk vrava për të kërkuar falje.

TODI — Po shkoj unë në vendin tënd, o Kapedan!

KAPEDANI — Jo! Ti je i ri dhe malet kanë nevojë për ty... Si thotë kënga: «Të tjerët që vijnë pas nesh — Më bukur nga ne do të këndojnë...» Në vendin tim do të shkojë Dani...

DANI — Unë?! Po unë ju thashë... Ja fundi i asaj marrëzie!

TODI — Kapedan!

DANI — ... Po vjen roja.

KAPEDANI — Todi, kam lënë koburen te Lisi i Rrufesë. Në dalç i gjallë këndeje, çoja Margës dhe i thuaj se atë e varën.

XHANDARI — (Ka hyrë) Në emër të lartmadhërisë...

KAPEDANI — E vjetër është, po qëllon mirë.

XHANDARI — Në emër të lartmadhërisë, Kapedan...

DANI — Faleni, faleni!

KAPEDANI — Ai jeton për mëshirë, o Todi! Nesër ka për të lëpirë duart e zotërinjve.

DANI — Kërko të falur, Kapedan! Të tjerët do të vijnë pas nesh...

KAPEDANI — (Rojes) Nxirreni jashtë këtë se nuk është komit. Të tjerët nuk do ta shtrojnë kurrizin për tre aspra.

XHANDARI — Përfalu me shokët!

KAPEDANI — (Nis këngën)

«Lashë parmendën në arë batall,
aman, bej, ma bëj hallall!...

Do të puth me plumb në ballë»

XHANDARI — Përshpirtu me shokët!

TODI — Mos ia ndërpre këngën, se e paguan me kokë, vëlla! Ti e di: komiti fërshëllen me plumbin!

(Bien tamburë. Në oborr grumbullohen njerëz.)

FËMIJA — E pse po e varin?
NJË GRUA — Deshi bukë.
FËMIJA — Deshi bukë dhe nuk i dhanë?
FSHATAR — Thonë se deshi të vriste bejlerët.
FSHATAR — Njërit ia teri opingat!
FSHATAR — Kollaj të duket ty, po ata ia hëngrën ko-
kën.
FSHATAR — Mjerë ne, thuaj!
FSHATAR — Po thonë se deshi të qethte dhe vetë da-
shin me këmborë.
FSHATAR — Pusho, plendës!... Xhandari!
FSHATAR — A është e vërtetë që do t'i varin të tre?
FSHATAR — Të shohim.
FËMIJA — Obobo, unë kam frikë!

(Nga qelia ndihet kënga)

FSHATAR — Pushoni se po këndojnë!
«Do të puth me plumb në ballë,
se nuk jam çanak me dhallë:
jam komit — harbut me pallë...
Aman, bej, ma bëj hallall!»

KAPEDANI — *(Heq mëngoren dhe ia jep Todit.)* Mba-
je se të duhet! I thuaj Margës se unë nuk kërkova
falje. *(Del i shoqëruar nga xhandarët.)*

DANI — Kapedan, kërko falje, Kapedan!...

FSHATAR — Bobo, sa e tmerrshme!

FSHATAR — Kushedi si i dridhen këmbët!

FSHATAR — Po vjen Kapedani!

XHANDARI — Hapni rrugën! Hapni rrugën!

FSHATAR — Mbahu, Kapedan!

XHANDARI — Kush foli?

OFICERI — Ec përpara, ti!

KAPEDANI — Prit të dredh cigaren!

FSHATAR — Prifti! Po vjen prifti, hapni rrugën!

FSHATAR — Ç'e nxjerrka tymin fjollë në anë të mustaqes!

FSHATAR — Pusho, more, se xhandari!

FSHATAR — Ai ka ngrënë zemër skifteri... Qesh përpara litarit!

OFICERI — Ngjitu lart!

KAPEDANI — Hiqmu ti! (*Shkon te shkëmbi dhe ngjitet vetë mbi të.*)

PRIFTI — Kërko falje, bir! Gjithmonë i paudhi...

(*Kënga në eho*)

«Prit, o bej, të dredh cigar!

Më pret trekëmbëshi, një litar...»

FSHATARËT — Po vijnë xhandarët!

KAPEDANI — (*Kënga në eho*)

«Me barut e shuaj urinë,
beut ia pres të zi qefinë...»

XHANDARI — Shpërndahuni!

(*Ndihet troku i kuajve. Rrëmujë*)

AKT I I PARË

Tabloja e parë

(Në kasolle. Marga i sheh plagën Pirros)

MARGA — I ke shpëtuar plumbit të dytë se, po të të kishte mbetur në mish, me plumb do të ta nxirrnim... Nuse! Sill vaj të nxehtë t'ia djegim plagën!

NERËNXA — Vaj nuk ka, nënë.

MARGA — Atë që kam lënë për koburen. Nxehe mirë në tigan dhe futi një gjysmë luge spec! (*Nusja del*) Të dhemb ca, po do ta durosh.

PIRROJA — Mirë!

MARGA — Nuk paske fjalë.

MITI — Kemi bërë rrugë të gjatë dhe ai ka humbur shumë gjak.

MARGA — Ik ndihmo tët shoqë, se nuk e gjen dot. Kujton se kam vaj të veçantë për koburen! Merreni nga kandili i ikonës! (*Del Miti.*) Marinë, dil e shih mos vjen njeri! (*Marina del.*) Je kaçak?

PIRROJA — Jo!

MARGA — Ata janë trima. Në grykë të kobures e kanë kafshatën... Hë, sa hambare bejlerësh kanë shpërthyer! (*Hyn Marina.*) Po ty pse të plagosën?

PIRROJA — Rraha dikë.

MARINA — Nuk ka njeri, nënë!

MARGA — Shko e thuaju të sjellin vajin! (*Marina largohet.*) Është ime mbesë... Sidoqoftë, gjersa ke rrahur një njeri dhe fshihesh, ai duhet të ketë qenë njeri i qeverisë. (*Miti sjell vajin.*) Gratë të dalin jashtë! (*Marina bën sikur del.*)

MITI — Mbaje veten, burrë!

MARGA — Je i martuar?

PIRROJA — Jo!

MARGA — Po nënë shkreta rron?

PIRROJA — Po!

MARGA — Shtrëngoji dhëmbët dhe mos lëviz! Ah, nënë shkreta nuk di gjë! Mos lëviz, po të them! Shaminë! (*Miti ngrihet të marrë shaminë, Marina i jep shaminë e kokës.*) Nuk paske dalë ti?!... Kështu është, or bir, kur burrat vuajnë, gratë derdhin lotë.

MITI — (*Ka sjellë shaminë. Vjen dhe Nerënxa*) E, nënë?

MARGA — Mjaft që plumbat nuk kishin prekur në koskë, se do të kishim avaze pastaj... Çohu dhe ec!

MITI — Lëre, të qetë, nënë!

MARGA — Aha, nuk qenke burrë! (*Pirroja provon të ecë. Ecën pak. Përplasët.*)

NERËNXA — U vra, nënë!

MITI — Të thashë!

MARGA — Sidoqoftë filloi të ecë... Shtrijeni dhe të mos lëvizë!

(*Nga larg dëgjohet një këngë:*)

«O litar të qofsha falë,
mos e var atë deli djalë!
Në ato male e suferina,
dritë i bënte vetëtima...»

MARGA — Po vjen.

NERËNXA — Kush?

MARINA — Po vjen baba Dani.

PIRROJA — Kush është ai?

MARGA — Ik ti, Marinë, dhe mos u duk më.

(Marina del. Kënga vazhdon.

«Dil e prite matanë fshatit,
ja tek vjen shëndoshë!...»

MITI — Mos e futni këtu!

MARGA — Në pyetë për mua, i thuaj se nuk jam.

(Kur del nusja kënga forcohet.

«Ruaju syrit, moj belholla,
kur ta përqafosh!...»

DANI — Ku është Marga, nuse?

NERËNXA — Shkoi të mbledhë pulat.

DANI — Kujton se ia kam unë fajin.

NERËNXA — Unë nuk di gjë, baba Dan.

DANI — Përpara se ta çonin tët vjehërr në litar, mua
ma dha koburen dhe më tha: «Jepja Margës!».

MARGA — *(Nga shtëpia)* Puh, ç'gënjen maskarai!

DANI — Dhe e bëra të njohur në fshat, se unë i pari
ia këndova këngën.

MARGA — *(Po nga shtëpia)* Ai, më duket, po mban
anën e bejlerëve. Po mirë thonë «Gomari — go-
marin kruan!»

DANI — Dhe po i jap nam, po Marga nuk mban kandar
dhe merr zjarr kot.

MARGA — *(Del)* Po i jep nam duke u fshehur nëpër
linjat e grave!

DANI — Pse ndër linjat e grave?! Më kanë rënë sho-
jet e këmbëve mua me flamurin e çetave në dorë.
A nuk qemë ne të dy, që kënduam me zë të lartë?!
Po kështu e ka kjo botë: një vritet, tjetri vazhdon
këngën...

MARGA — Dhe ti me këngë kërkon të mbulosh turpin?!
DANI — Ç'flet, moj Margë! Në do të dish, para se yt
shoq ta godiste me plumb në ballë, unë i pari e
mbërtheva për fyti Kapllan beun... Pse nuk kër-
koi falje yt shoq? Apo ia pata unë fajin? (*Nerën-
xës*) Mori veten më qafë, nuse!

MARGA — Ik!
DANI — Zaten e çmendur ke qenë ti!
MITI — (*Del*) Nododhi gjë?
DANI — Ou, paske erdhur ti?!
MARGA — Po, të marrë plaçkat. (*Nerënxa largohet*)
MITI — Foli gjë apo më bënë veshët?

DANI — Mos e merr me zjarr, o djalë! (*Në të ikur*) Ki-
sha një fjalë me Margën. Nejsë. Bëje të mirën dhe
hidhe në det...

MARGA — Diç i ka rënë në erë atij, pa erdhi këndeje.
MITI — Po u duk edhe një herë, do të ma gjejë kokë-
zën e kandilit.

MARGA — Lëre kokën e kandilit! Dil dhe kaloji për-
para syvë të mendojë se ke ikur... Pastaj kthehu!
(*Pirros*) Im shoq koburen ia dha Todit.

PIRROJA — Tod Rrjepacakut?

MARGA — Po! E njuh ti?

PIRROJA — Kam dëgjuar.

MARGA — Është bërë tmerri i bejlerëve. (*Mitit*) Ti
bëj si të thashë. (*Miti del*)

PIRROJA — Pastaj, nënë Margë?

MARGA — Asgjë! Unë rrita jetimët me kobure në krye
të vatrës...

NERËNXA — Dhe jetimët, po jetimë mbetën, nënë!

MARGA — Ti je e re, nuse, po, kur të lindësh tët bir,
veri koburen nën jastëk dhe këndoï këngën e lita-
tarit. (Nusja del)

PIRROJA — Këngën e litarit?!

MARGA — Këngën e gjyshit... T'ia këndojë më parë që
të mos e mësojë nga goja e maskarenjve dhe të mos
bëhet spurdhiak e të shkojë rrëzave si qentë e
zgjebosur...

Tabloja e dytë

(Kur largohet Marga, ndihet «Kënga e Harbutit»)

K O R I

«Më quajnë hajdut, unë jam harbut!
Një pushkë, një thikë kam pasuri...
Unë dua bukë, beu m'jep kamxhik
dhe s'pyet për zot e djall të zi!
Ç'ti jap unë beut, veç shpirtit tim?
Një plumb një thikë!»

Unë jam harbut, më quajnë hajdut:
s'kam frikë, me ujk e bishë rri!
Kur shoku ndodhet në rrezik,
nuk pyes për zot e djall të zi!
Godas, kur hëna pas reve ndrin:
me plumb, me thikë!»

MARINA — Do dhallë?

PIRROJA — Jo!

MARINA — Po të bëj sherbet elbi?

- PIRROJA — Jo, më mirë më sill dhallë.
- MARINA — Dajë Miti u nis për në kompaninë rrugore, atje ku ishe ti.
- PIRROJA — E di... Po nënë Marga ku është?
- MARINA — Ka shkuar në pyll, të mbledhë barëra, për të përgatitur ilaçe për ty... Nuk beson? Ajo sot ka shkuar tamam për këtë punë... Se ndonjëherë shkon edhe për të lajmëruar kaçakët.
- PIRROJA — Pse?
- MARINA — Për ato që ngjasin këtu.
- PIRROJA — Janë shumë ata?
- MARINA — Po... Këtu vijnë dy a tre. Pastaj mblidhen dhe burrat e fshatit e bëjnë muhabet.
- PIRROJA — Bëjnë muhabet? Përse?
- MARINA — Nuk e di... Një herë pata dëgjuar se andej nga Darësia kishin vdekur nga lakrat.
- PIRROJA — Si nga lakrat?!
- MARINA — Lakrat duhet të hahen me vaj dhe me miell, thotë nënë Marga, se të gërryejnë zorrët... Dhe këtu vdiqën tre veta. E di ti?
- PIRROJA — Jo, nuk e di...

(Dëgjohet kënga e Gjeraqinës)

- MARINA — Shih, filloi!
- PIRROJA — Kush këndon kështu?
- MARINA — Një fshatari ynë.

«Kënga e Gjeraqinës»

«...As ta ka ty fajin këmba,
që po ecën si ndër gjemba,
Gjeraqinë në lëndinë!
Vrapo pyjeve, kërcure,

nëpër natë, ku kris kobure,
një bilbil po ligjëron...»

MARINA — Ka gjëra këndeje që të ngjethet mishi, kur i kujton... Ja, e shkreta Dritë e Meçajve nuk gëzoi të bëhet nuse.

PIRROJA — Pse?!

MARINA — Se... e kapi qehajai. Dhe ajo, dha e dha, nuk duroi dot turpin dhe u hodh në pus.

PIRROJA — Ishte e fejuar ajo?

MARINA — Jo! Thonë se është bërë lugat i natës: qan e lebetit nëpër fshat dhe qëllon me gurë sarajet.

PIRROJA — Çfarë thotë kënga?

MARINA — Hë! Kënga?!... E këndon bukur ai këngën e Gjeraqinës.

PIRROJA — Po babanë ku e ke, Marinë?

MARINA — E çau ujku në malet e Çajupit, tek korrite bar. Nëna u martua dhe unë erdha këtu.

(Rrugës kanë ndaluar të dëgjojnë këngën gra të ngarkuara)

TINA — Mori pyet ajo!

DAFINA — Vërtet!

LENA — Ashtu është, moj motër, ia njihte të shoqit dhe krismën e kobures. *(Dafina qesh.)*

MARGA — Mos qesh, Dafinë!

(Marina del e ndihmon Margën)

GRATË — Si je, Marinë?

MARINA — Si jeni ju?

MARGA — Marina? Aq jetë ka dhe ajo sa të bëhet grua. *(Marina largohet me turp)* Ku shkon, Marinë?

MARINA — Do shkoj të shoh pulat.

MARGA — Nuk do, që nuk do të martohet... Ka frikë fatin e së ëmës.

LENA — E turpërove, nënë Marga.

MARGA — Po dhe në u martoftë, do të bëjë një vatër me kalamanj. Ata do të rriten dhe do të marrin rrugët... I varfëri shtohet si hitri, moj bijë, se ka nevojë për krah pune.

TINA — Ç'të bësh, nënë Margë, kështu qenka shkruar për ne.

MARGA — Dhe gratë dinë të qajnë me derte hallet. Mjerë kasollja!

(Dafina qesh)

TINA — Pse qesh, moj nuse?

DAFINA — Jo po... Ku e di unë...

LENA — Gjithë ditën e perëndisë, sa hap e mbyll synë dielli, në po në këmbë mbetemi.

MARGA — Nuk më zë gjumi për djemtë tanë. Po shuhen rrugëve...

TINA — Ikim, nënë Margë, se u bë vonë.

GRATË — Mirupafshim!

MARGA — Shëndet e të mira paçi!

(Sa hyn në kasolle, del dhe e pret Nerënxa)

MARGA — Nuse, zieji këto barëra, të na i pijë ky zo-
tëria e të na marrë fuqi. *(Nusja i merr dhe del.)*

PIRROJA — Unë zotëri?!

MARGA — Si e ndien veten?

PIRROJA — Do të iki nesër.

MARGA — T'u mërzit shtëpia?

PIRROJA — Jo, kam ca punë që nuk presin.

MARGA — Shko, se dhe im bir shkoi. Dëgjo, sonte kam miq. Do të qëndrosh?... Ti pi raki?

PIRROJA — Po... edhe pi!

MARGA — Kujtova se mos merresh gjithë ditën vetëm me fjalë... (Me vete) Burrat kanë arratinë, dikush kaçak, dikush endet... Të shkretet, thuaj!

PIRROJA — Për kë e ke fjalën?

MARGA — Për gratë.

MARINA — (Hyn) Po vijnë.

PIRROJA — Kush janë ata?

MARGA — Do të të njoh me Todin... Nuk do?

PIRROJA — Sa mirë të ka vajtur mendja!

MARINA — A të qëndroj dhe unë sonte?

MARGA — Na lër rehat, tani, Marinë!

PIRROJA — Mirë është të qëndrojë, nënë Margë.

MARGA — Bëni gati rakinë!

(Hyjnë dy kaçakë. Todi njërën këmbë e ka të zbathur dhe opingën në brez.)

TODI — Të mirat në shtëpinë e Margës!

MARGA — Ç'je bërë kështu, kapedan?! Mos ec me një këmbë se do të të vdes gruaja!

PALI — Shkeli në një rrëzë misri dhe e ka dënuar veten të rrijë zbathur.

MARGA — Shikoje, shpërtheu burgun!... Ka qenë me tim shoq.

TODI — Nga e kemi këtë zotëri?


PIRROJA — Punëtor. Shtroj rrugë me gurë, o kapedan. Jam nga ata të «Bashkimit».

TODI — A e njeh Naunin?

PIRROJA — Cilin, Naun Dokon?

TODI — Po!

PIRROJA — Jam shok i tij.



MARGA — E kanë plagosur.

TODI — Kush?

PIRROJA — U shemb mali, tek punonin. Dhjetë nga punëtorët vdiqën. Unë rraha atë që drejtonte punën...

MARGA — Ngreje, kapedan!

TODI — Gëzuar!

PIRROJA — Gëzuar!

PALI — Gëzuar!

MARGA — Ju bëftë mirë!

PIRROJA — Qenke bërë si Krishti, kapedan!

TODI — Nuk po të marr vesh.

PIRROJA — Si Krishti, thashë, se dhe ai e dënonte veten për të ngjallur mëshirë.

PALI — Shiko ti, djalë i mirë...

TODI — Prit, o Pali!

PIRROJA — Lëre! Nuk kam frikë nga pushka e kusarëve unë...

TODI — Dëgjo, ti! Jemi tjetër stan ne dhe nuk kemi të bëjmë me ato çeta kusarësh... Prandaj rri e mos na prish rakinë.

MARGA — (*Pirros*) Në ke ardhur si mik...

PIRROJA — Po ky gënjen veten dhe njerëzit, nënë Margë; bejlerët hajdutë të popullit, ky hajdut i bejlerëve!

TODI — Pse, një llojë është?

PIRROJA — Në mos më keq!

MARGA — Ç'thua, more! Ai ka vrarë tre bejlerë.

PIRROJA — Ja, vrau dhjetë, çliroi botën?! Ç't'u bësh gjithë atyre, që kanë grumbulluar misrin tani në kohë të zisë... Në çifligun e Hanëmit njerëzit nuk kanë tokë për t'u varrosur e ti... Më shpërtheke një hambar, o kapedan!

TODI — Kush e solli këtë, Margë?

MARGA — Miti.

TODI — Po Miti ku është?

MARGA — U kthye në kompaninë rrugore.

PIRROJA — Jo, nuk shkoi në kompani.

MARGA — Po ku shkoi ai?

PIRROJA — Rrugëve, si unë, nënë Margë.

MARGA — Rrugëve?!

PALI — Rrugëve?... Ore, a të kanë lidhur ndonjëherë ty?

PIRROJA — Pse?

TODI — Prit, o Pali, prit!... Na e djallosi të bekuarën.

PIRROJA — Ti e di, kapedan, Zogu e vrau Avni Rustemin... Po të lihen, ai dhe bejlerët që janë bashkuar bythë më bythë, do të na i hanë kokat një e nga një... Ti më pyete, ore mik. Po, kam qenë i lidhur.

PALI — Sikur të mundja e t'i përmblihdja të gjithë bejlerët në një grusht, do t'i shtrydhja e do t'ua nxirrja ndyrësitë nga goja...

PIRROJA — Në Nikaj-Mërtur u vunë drunë bejlerëve, bajraktarëve.

MARGA — E fundi?

PIRROJA — Mbetën vetëm përpara ushtrisë që dërgoi qeveria... Todi yt bredh pyjeve, për të vrarë ndonjë që tepron zullumin.

TODI — Mirë e ke ti, po gjithkush në çetën time mban mbi kurriz hallin e vet. Për një mezhde ia hëngrën kokën Nasit dhe i vëllai kërkon shpagim vetëm për kokën e tij.

PIRROJA — E po, feudalizmi nuk është një bej, o Todi! Dhe as pyet në e dënon ti veten për një rrëzë misri.

TODI — Lëre, dreqin!... Po hajde e merru vesh me ta, se...

PIRROJA — Posi, shkojmë!

MARGA — Hajt, ngrini gotat!

TODI — Na e bëri ujë ky miku.

PIRROJA — Jam gati, kapedan!

TODI — Je gati ti, po...

PALI — E pse të mos shkojmë, o kapedan?!

TODI — E po... Provojmë, o Pali! (*Pali prin. Pirroja
çalon*) More djalë! (*I tregon këmbën*)

PIRROJA — Jam mirë. U zemëruat? (*I jep opingën*)

TODI — Fjalë qenë, nuk qenë plumba.

MARGA — Po ju e pinit me fund të shkretën, pastaj...

TODI — Mirupafshim, Margë! (*Ikin*)

AKTI I DYTË

Tabloja e parë

(Panair. Çdo gjë zhvillohet në kalim.)

SHITËS — Çerturina! Për nuse karfica, temina!.. Çerturina!

SHITËS — Peshk i tharë! Peshku i kripur me bukë të misërt forcon dhëmbët... Bakalaro!

SHITËS — Krehre të fortë, krehre për morra! Urdhëroni myshterinj, krehre për morra!

SHITËS — Sheqer deti, sheqer deti! O afër detit, o afër mbretit! Kripë, ore kripë! Sheqer deti për zotëri, urdhëroni, myshteri!

SHITËS — Çerturina!...

LAMI — Jep, të dhëntë zoti!

«Sa lesh, mbi tre desh,
aq bereqet të kesh!
Ç'të jep zoti,
s'të sjell moti...»

NDREU — Po ty pse nuk të ka dhënë zoti, o Lami?!

KOLI — Ka frikë se mos bëhet bej.

TAKSIDARI — Hill Tashi!

HILLI — Nuk kam të të jap, në do shpirtin, merre!

- TAKSIDARI — Taksa e qeverisë dhe haku i perëndisë nuk mbahen.
- HILLI — E po kur nuk ka as për perëndinë, ç'do të marrë qeveria?
- QEMALI — Pse nuk jep ti?
- HILLI — Ç'të jap?! Shtatë herë e kam shpërngulur truallin dhe mbeta si kërmilli me shtëpi mbi kurriz.
- QEMALI — Trutë e tua të japësh!... Se për të shkuar pas atij, Rroko Dokos — si i thonë — Naunit, jeni të vetmit ju.
- ZËRA — Po nuk kemi, bej!
- QEMALI — Nuk doni. E keni bërë gojën për të ngrënë me nder... mallin e të tjerëve! Oj, ne me grurë e ju me gurë! Mblidhni mendtë se, për nder, keni për t'i marrë brekët nëpër këmbë e t'i thoni zotit ç'të kemi bërë!.. Dhe shkoni e ankohuni, pastaj, në ato shoqëritë tuaja: «Opinga», «Xhoka» dhe çfarë keni ju...
- PIRROJA — As kanë për t'u ankuar më ata, o bej... Dhe me zotërinë tënde kot që bëjnë fjalë.
- QEMALI — Kush je ti, more, fytyrë e paparë?!
- PIRROJA — Unë?.. Jam nga Vër... Vër...
- QEMALI — Vërdhoma?
- PIRROJA — Jo, nga Vër...topi, bej, se m'u mor goja.
- QEMALI — A mos je dhe ti nga ata të Rroko Dokës, se si shumë të hollë e paske atë gjuhë.
- PIRROJA — Unë shes kumbulla, o bej. Dhe u thashë atyre të mos bëjnë fjalë me zotërinë tënde, se ti ke hallet e tua e bën pazarin tënd, o bej. Unë bëj pazarin tim.
- QEMALI — Dhe si shkon pazari?
- MARGA — Tre grosh fustani i grave, bej!
- QEMALI — Nuk pyeta për fustan, harbutkë!
- MARGA — Përse pyete, zotrote, për bereqet? Bere-

qet nuk ka. Në mos na dhënc zotrote, do të çall-
tisim të gjejmë.

SHITËS — Për nuse karfica, temina!..

QEMALI — Ore, çertexhi!

SHITËS — Dhe ne nuk bëjmë pazarin tënd, o bej! Pa
s'kemi nge dhe të të dëgjojmë, se duam të shesim.

QEMALI — Çfarë do të shesësh, more qafir!? Përpara
meje?

SHITËS — Krëhëra për morra!

SHITËS — Bakalar!

LAMI — Jep, të dhëntë zoti!

QEMALI — Largoje atë!

QEHAJAI — Hiqu, more! Merr vesh?!

LAMI — Jep, të dhëntë zoti!

NDREU — Rri, o Lami, për kokën tënde! Ne jemi bërë
vetë për të lypur...

Tabloja e dytë

FSHATARE — Të vjen Todi sonte?

LENA — Kështu thonë.

FSHATARE — Po të doli burri kaçak, është e kotë që
të rrish në shtëpi, moj motër.

LENA — Pse?

FSHATARE — Po, ç'e do atë jetë! Je si ajo që dëftejnë:
pret Milon t'i kthehet nga kurbeti për ta puthur.

FSHATARE — Dhe më keq, se, kur vjen yt shoq të
puth rrëmbimthi, dhe sa të mbyllësh e të hapësh
sytë, ai të ka fluturuar.

LENA — Ah, po ti nuk e di, moj e shkretë, sa e zjarhtë
është ajo puthje e rrëmbyer.

MARINA — Puthje kaçaku, puthje me plumb!

LENA — Jo, moj! Goca për martesë! T'i japim sihariqin
nënë Margës!

MARINA — Unë nuk thashë gjë.

ZËRA — Karnavalet! Erdhën karnavalet!

— Hapni rrugën!

— Hapni rrugën!

(Aktorët, përkatësisht, lozin rolet e figurave, duke hyrë e dalë pas perdes)

AKTORI a. — Të dashur vështronjës! Në karnavalet tona «Mbahu Muço, me gajret!»

AKTORI b. — Se te dera vdekja pret...

AKTORI c. — Lozin: Muço Damllaja!

AKTORI b. — Nuk i hahet bakllavaja.

AKTORI c. — Thonë mik e ka dhe mbreti...

AKTORI b. — Rroftë, pra, sa një gjeldeti!

Faruk Vrroma!

AKTORI a. — Sorra ndjell sorrën,

AKTORI b. — Kopuku, kopukun.

AKTORI a. — Faruku?

AKTORI c. — Kolltukun.

AKTORI a. — Llaz Leshi!

AKTORI c. — Prifti mendje femër!

AKTORI a. — Grekun mban në zemër.

AKTORI c. — Kur në xhep i venë paranë,

AKTORI a. — Shku! ungjillin — ngul kuranë!

AKTORI c. — U ngrit Muçoja pa gdhirë.

AKTORI b. — Lau sytë, harroi peshqirë.

AKTORI a. — Bleu votat Pilo Preshi,
bleu sa deshi!

AKTORI c. — Do të bëhet deputet!

A. C. — Ç'thua ti, uratë, Llaz Leshi?

AKTORI b. — Vraje të ligun, se të vret!

A. B.C. — Pilo Preshi, maskara,
bleu votat me para!

AKTORI c. — Lipi!

NJË ZË — Lepe!

AKTORI c. — Piqe!

ZËRI — Peqe!

AKTORI c. — Po koburen e ke plot?

ZËRI — Po, im zot!

AKTORI c. — Shko, plagose Pilo Preshin!

a. b. c. — Pilo Preshi, maskara,
na thau rriskun me para!

AKTORI a. — Po s'dha votat, shko i thuaj..

AKTORI c. — O kokëthumb!

AKTORI a. — Ta martoj tët atë me plumb!

AKTORI b. — Po nuk deshi Pilo Preshi

AKTORI a. — Bëje dhëndër

a. b. c. — Dhëndëro mustaqe zi,
deputet në qeveri!

*(Karikatūra e personazhit mbi «Karrocën e vota-
ve»)*

AKTORI a. — Deshi, s'deshi Pilo Preshi...

AKTORI c. — Me karrocë erdhi peshqeshi.

AKTORI b. — Kështu e ka bota!

AKTORI a. — Ecëm mbi rrota,

AKTORI c. — Lëviz me vota...

AKTORI a. — Kush të vrau?

AKTORI c. — Opozita!

AKTORI a. — Njerëz të liq...

AKTORI b. — Lavdi zotit që nuk vdiq!

AKTORI a. — Popullorë, demokratë...

AKTORI c. — «Bump!» kopaçja,

AKTORI b. — «Vërr!» paratë!

AKTORI c. — Për t'u zgjedhur Asambleja,

AKTORI a. — Nga Tirana s'erdhi leja.

AKTORI b. — Prit e s'ka... u ftoh kafeja!

AKTORI a. — Të dashur vështronjës!

AKTORI b. — Kush nuk qeshi — le të qajë!

a. b. c. — Karnavalet s'ju kanë faj!...

(Karnavalet largohen)

ARIXHESHA — Kanistra dhe shporta!

FSHATAR — E bija te dera, e ëma te porta! Më hidh fall!

ARIXHESHA — Do të them një gjë, të keqen, hatri të mos të të mbesë! Një zog të këndon në derë, ti mos i beso! Kokën do të hajë!... Dhe një shkurtamane dhe një trashamane, po të mban në gojë, po të keqen të të marrë... Një grua, nga dera e nënës, shpirti po i digjet, zemra po i piqet, të ka bërë magji...

TELLALLI — Ej, millet...

(Pazari ngurtësohet në dëgjim.)

Princi Karagjoz... e viçi i Jugosllavisë, thotë se edhe po t'i jepet froni, nuk pranon të bëhet mbret i Shqipërisë.

KORI — Viç the?!... Karagjoz!?

TELLALLI — Nuk e di, kështu më thanë...

KORI — Sa qibar!

Në Shqipëri nuk do i parë!

TELLALLI — Ej, millet!

Gjakun mos e prish,

Fuqitë e Mëdha do të sajojnë një mbret!

(Veprime të çlirta)

FSHATAR — Do të bëhet bereqet apo jo? Këtë më thua, po sa për shkurtamanet e trashamanet...

ARIXHESHA — Bereqeti dhe fëmija janë punët e zotit, të keqen; e di që mbjell, po nuk e di çfarë korr!...

Tabloja e tretë

(Vjen Todi me Palin.)

TODI — Mirë se ju gjej!

— Mirë se erdhe!

TODI — Teket i mbushni me plumba se do të gjuajmë derra të egër. Do të grumbullohemi te shelgjishtet e Lumit të Vjetër...

PIRROJA — *(Merr koburen e Margës dhe qëllon një qen.)* Burra, kështu do t'i qërojmë të gjithë bejlerët!

KOLI — Dhe Nauni këto fjalë tha, kur vrau një qen midis pazarit dhe e varrosi përpara shtëpisë së Vrionasve.

HILLI — Po ky kush është, o kapedan?

TODI — Një nga ata të shoqërisë «Bashkimi».

SHITËS — Do të merrni veten më qafë!

PALI — Vdekje frikacakëve!

PIRROJA — Hakmarrja e vërtetë tani fillon!

(Ndërkohë që prin këmbëzbathuri, Marga ndalon.)

MARGA — Prit, o kapedan, dhe mos e merr nxituar!... Po zgjati lufta, çdo të hash ti, bar?! Qemal Vrroma nuk ta jep kafshatën, sikur të ngordhësh. Dhe ta dish se dyfek zorrëthatë nuk bëhet.

TODI — T'i merret misri Qemal Vrromës!

PIRROJA — Gratë dhe ata që mbeten këtu, me Margën në krye. Të tjerët, prijë, kapedan!

(Në kryqëzim rrugësh kalojnë gra të ngarkuara me thasë misri. Skena zhvillohet në pantomimë, ku spikasin disa çaste)

DANI — (*Tërheq qenin*)

«Kam një kotruve, të thyer me një anë,
kur pi ujë me të, më lanë gjithë suranë...»
(*Qenit*) Si thua ti, kokën e tyre kanë për të ngrënë,
ë?!... Ja dhe kjo nuk qe parë: një qen — një bej!
Shkove bedel, more i shkretë!... Të paskan lidhur
me kollaro, pa le!

QEMALI — (*Në të ardhur*) Unë që ta fala jetën, unë ta marr përsëri. E sheh se ç'po bëhet këtu, në këtë pazar?

DANI — Vranë një qen, bej. Dhe unë e mora ta hedh në hendek, të mos na qelbi vendin.

QEMALI — More, lëre qenin! (*Drejtohet nga pantomimat*) More harbut, ç'e ke atë thes me misër?!

LAMI — (*Thesin e ka bosh*) Thes me lesh, thuaj, me lesh, pa misër... Sa vajta unë nuk kishte mbetur kokërr. (*Shkund thesin përpara tij.*)

QEMALI — Të lajmërohen xhandarët! (*Kalon*)

DANI — (*Tërheq qenin*)

«Gurë hobeje, gurë varri,
mu në ballë t'i hedh i marri!
Më mirë plumb në luleballi,
se i vdekur për së gjalli...»

(*Dani kalon. Dëgjohet një thirrje, në një çast pantomimat ngurrosen në përgjim.*)

— Vdiq, ore vdiq, vdiq!... Mblidhuni se vdiqën!
MITI — Po thuaj, more, kush vdiq?
— Vdiqën bejlerët, po i sjellin me arkivol...

(*Kortezh. Mbi arkivol kufoma e qenit. Lami del e prin*)

- LENA — «Aman bej, se s'kam ç'të jap!
Nuk ha bukë, unë ha farmak...
- KORI — Aman, bej!
- LENA — Dil, o bej, o more pusht,
t'i pjekim hutat gushë më gushë!
- KORI — Bej, or bej!
- LENA — Do ta shtyp kokën me grusht,
gjerë e gjatë do të të shtrij në fushë!»
- KORI — «Aman bej, qafsh kokën tënde!
Jak të pres kostum të ri,
jak, o jak, se në këto vende,
ta qëndis për bukuri!..»
- PIRROJA — *(Sa vjen)* Ç'është kjo që po bëni kështu,
vëllezër!?
- MARGA — Po e djegim me qiri, o Pirro!
- PIRROJA — Ti e bërë këtë, Margë?!
- MARGA — Jo, ai. *(Tregon të birin)*
- MITI — Unë me një shokun tënd. Ç'të bëjmë që nuk
gjetëm dërrasa, pa të shihje ti...
- PIRROJA — More, më duket se këto janë lodra kala-
manjsh dhe ne po lozim me fatin tonë.
- MITI — Në Berat ishte bërë nami e ti thua lodra: një
alamat qivuri kishin bërë ata që...
- PIRROJA — Ashtu?!... Nejse. Mundet, mundet...
- LAMI — I thonë harbutëri kësaj, vëlla, të ta krip me
saçma! Hë, tani! Treqind grosh vërë e miut dhe
ku ma gjen.
- PIRROJA — Shokët na presin te shelgjishtet e Lumit të
Vjetër. Të dalim e t'u pastrojmë rrugën atyre të
Vlorës...

P J E S A E D Y T Ë

INTERMEXO

(Në rrugë Qemal beu me xhandarë, shoqëron Todin të lidhur)

QEMALI — E, moj shtriga plakë, si të duket bota?

MARGA — Bota vjen anës, o bej!

TODI — Këtë zotëri unë do ta kisha therur për festë, nënë Marga, po ç'e do...

QEMALI — Me lëkurën tënde ti do të paguash dhe gjynahet e të tjerëve. Na!... (Qëllon)

MARGA — Mos! (Kafshon duart)

QEMALI — E di, nuk ke ç'bën... Dhe unë nuk kisha ç'bëja. Tani, fuqi e mbretit, dëshirë e zotit mbi dhé! Këtë këmbëzbathur unë do ta mbath me potkonj. Na!... (Matet ta qëllojë rishmëzi, Marga i kap kamxhikun)

MARGA — Ai i ka duart e lidhura dhe ti kërkon të shesësh trimëri!

TODI — Lëre të qëllojë, nënë Marga! Tani po e kuptoj se u morën me lodra kalamanjsh: dogjëm një qivur dhe ia lamë kokën mbi supë!... Tani lëre të qëllojë, të paguajmë gjynahun!

QEMALI — Hë, shtrigë! (Xhandarët e kapin Margën dhe e përplasnin në një anë.) Aty ka për të të dalë

shpirti, në pluhur... *(Ata mënjanojnë përpjekjet e Todit për të shkuar te ajo)* Dhe ky të shkojë e t'i falet tët shoqi tani...

TODI — Çohu, Margë, çohu se nuk vdes shpirti ynë!... Sido që të bëhet unë e kam një në djep dhe ti një e lë pas. Mbi hu kanë për t'ia bredhur kokën zotërisë në tërë Shqipërinë. Çohu, Margë, çohu!...

(Marga e vetme. Ndihën këmbanat. Lutje për shi.)

MARGA — Njërin e rrahën me kamxhik, tim biri i dhanë munxët rrugëve, të tjerët luten për shi...O zot i madh!

TELLALLI — Ej, millet!... Jeta e ashpër e luftës dhe e pushkës, që ka penguar zhvillimin dhe përparimin e popullit tonë, mori fund... Qeveria njofton se në të gjithë vendin mbretëron qetësi e plotë... Gjatë këtij muaji kanë lindur 314 meshkuj dhe 210 femra. Kanë vdekur 407 meshkuj, 352 femra dhe 71 fëmijë. Janë bërë 380 martesë, 10 ndarje dhe 54 shpërngulje...

...Nga një tas dhe një batanije do të ketë për secilin punëtor, që do të marrë pjesë në ndërtimin e Rrugës Mbretnore. Qeveria njofton se hyrja në kompani bëhet me vullnet, dalja me leje...

...Të gjithë ata që vuajnë nga uria, le t'i drejtohen me tas ministrit — më falni! — me lutje... për të ngrënë ministrin e Punëve të Brendshme. Dhe këto lutje, pastaj, do t'i paraqiten Kryqit të Kuq Botëror... Ej, millet! Dëgjoni dhe një herë për ta shkoqitur dhe më mirë: Bëni lutje në Ministrinë e Brendshme dhe keni për të ngrënë njeri tjet... si njëri, tjetri!

(Ndërkohë, njerëzit janë grumbulluar në lutjen për shi)

MARGA — Luteni?!

LAMI — Kur nuk ka, lutemi, Margë:

«O zot jepna sot!
Pa ç'sjellë era,
s'dihet mot!»

PRIFTI — (*Ndihet*) Dëgjoji lutjet e mëkatarëve dhe
jepi jetë e shëndet mbretit tonë, o zot!...

LAMI — (*Kruhet*) Rroftë mbreti!

HILLI — Na lër të falemi, Lami!

LAMI — Pse, ç'po bëj unë?!

KOLI — Rri e dëgjo! Janë të tjera kohë tani... (*Vijnë
dordolecët*)

LAMI — «Dordolecë bjerë, o shi!..»

DORDOLECI — (Rreth Margës) «Mbeti plaka në shtë-
pi!..»

MARGA — Kush je ti?

DORDOLECI — «Unë jam djall, vij vërdallë!

Më ndjek zoti me rrrufe,
se nuk kam as besë, as fe:
Desha që ta shtrijë përdhe!»

LAMI — (*Qesh*) Hahahaha!

NDREU — Pse qesh ti?

LAMI — «Koka bosh, barku kosh!

Sa do rrosh, do mësosh!..»

Unë i dija dordolecë dhe këta na qenkan djaj!

HILLI — Lami! (*I nxjerr dordolecët jashtë*)

DANI — Punë dordolecësh!... Në kishë prifti lutet për
mbretin, pa ç'ka se ai nuk është bir Krishti!

KOLI — Po ti nuk ke qenë kaq i mençëm, o Dani!

PALI — Njeriu sa vjen e piqet.

LAMI — Qerrata ky Dan... ky prifti ynë!

NDREU — E tha dhe Lami një fjalë!

HILLI — Lyp dhe lutu jeta e tij.

MARGA — Dhe mos shtrini dorë te i pasuri, se shtini shpirtin në gjynah.

LAMI — Duam të hamë.

MARGA — Kërko te i varfëri.

DANI — Morrat?!

MARGA — Nderin më parë.

LAMI — Nuk hahet nderi, Margë! Hahet buka...

KOLI — Më duket kohë e budallenjve kjo! Po na thonë fjalë të mençura.

PALI — Po na mbytin me duart e lëmoshës.

DORDOLECI — «Ai më tregon me gisht:

Ja, Jeziti! — Ah, Jeziti,

kundër fronit krye ngriti:

I vini brirë, i vini bisht...

Dordolec, bjerë, o shi,

të na bëhet misri i ri...»

DANI — Kërkojnë misër! Dëshëm qeveri pa mbret ne!..

Rrini, se po na rrodhën trutë dhe një herë...

PRIFTI — Dëgjoji lutjet e mëkatarëve dhe jepi jetë e shëndet mbretit tonë Zogu i Parë... Shpëtona nga i ligu dhe hidhna shi! Amin!

(Largim me thirrjen «Qirieleison!»)

MARGA — Kthehuni! Qielli nuk hedh misër! Gjithë jetën mbetët duke u lutur dhe më kot mbani sytë nga zoti, hambarët i ka beu.

LAMI — Provuam një herë dhe u rrëzuam për tokë, nënë Margë!

HILLI — Qe kafshatë e madhe ajo dhe nuk e përcollëm dot!

MARGA — Dhe po u lutët, në lutje ka për t'ju dalë shpirti, po kokrrën e misrit nuk keni për ta parë me sy. Duket se edhe zotit nuk po i vjen keq për ju...

PRIFTI — O mëkatarë! Dëgjomëni dhe, në emër të atit, gjykoni!... Thonë se dikur nga qielli binte miell. Po dikush, diku, na e përdhosi dhe e shkeli me këmbë. Dhe atëherë zoti derdhi zemërimin mbi mëkatarët: e ftohu miellin dhe e bëri dëborë... Kush qe ai brekëçjerrë që përdhosi përsheptjen e mëshirëplotit?! U gjend ai, o mëkatarë, arixhiu! Që nga ajo kohë arixhiu mbeti përderës dhe u end nëpër botë, pa i zënë këmbët dhe...

MARGA — Arixhiu?! Ai s'ka pasur ndonjëherë miell! Ai është më keq nga ne. As iriqë s'e lënë të mbledhi më nëpër gjerde.

PRIFTI — Dëgjomëni në fjalën e zotit, mëkatarë dhe, në emër të atit gjykoni! Lëngata e besnikëve të tu, gjynahu i fëmijëve të pa bukë do të bjerë dhe mbi ata që guxuan e ndynë shenjtërinë tënde, o zot! Ti i dënove me ferrin e burgut dhe të internimit, atdheu e vulli pjellën e ndyrë, që nuk e qas as deti dhe ata, antikrishtët, komunistë, do të enden nëpër botë si Juda, përderës të mallëkuar, pa u zënë këmbët dhe!... Arixhinj do të mbeten tërë jetën! Amin!

MARGA — Mos i tremb të varfërit të kërkojnë hakun e vet, o nëpërkë e zotit, se shpirtin tënd shtie në gjynah.

FSHATARI — Marga!

PRIFTI — Mallëkimi ynë rëntë dhe mbi atë që guxon e prek lavdinë tënde, o zot!.. Qëkurse kjo shtrigë hoqi besimin ndaj të gjithëpushtetshmit dhe qëlloi me plumb kundër tij, qielli u drodh e nuk hedh shi... Ajo kështu do të endet gjithmonë dhe nuk do të ketë as shtëpi, as varr! Amin!

MARINA — Ti mos paç as shtëpi, as varr!

FSHATAR — Marina!

MARGA — I varfëri mban sytë nga qielli dhe ti jep mallëkime!

PRIFTI — Besimtarë!

MARINA — E çfarë të besojmë te ti?! Ti nuk deshe të varrosje Dritën e Meçajve në kishë, kur u mbyti në pus dhe the se e ka thirrur zëri i të paudhit dhe jo se e mbyti qehajai...

PRIFTI — Besimtarë! Jezui tha: «Nga veza e gjarpërit, gjarpër do të lindë! Dhe kjo racë e mallëkuar, përdërëse ka për të mbetur gjithë jetën!

(Ndërkohë turma është larguar. Me Margën e Marinën kanë mbetur Koli, Ndreu, Pali. Vjen Miti me Pirron)

PIRROJA — Shëndet, nënë Margë!

MITI — Është Pirroja, nënë.

MARGA — Pirroja the?!.. Të dija të vdekur.

PIRROJA — Nuk vdesim ne pa mbaruar dhe ca punë në këtë botë. Nuk do t'i lëmë përgjysmë. Ti si je, nënë Margë?

MARGA — Si zogu i korbit! Më lanë gjallë.

PIRROJA — Pali, ai që ka qenë. Apo jo, Ndreu? Koli qenka mbledhur ca.

KOLI — E po jeta bën të vetën...

PIRROJA — Marina sa paska ndryshuar!

MARINA — Po të mos kishte thënë dajë Miti, unë as do të të kisha njohur...

MITI — Ishim në shtëpi... Ndodhi gjë me ty?

MARGA — Jo!

PALI — E mallëkoi prifti para të gjithave.

MITI — Ku shkoi prifti?

MARGA — Nuk e di.

MITI — E gjej vetë.

- PIRROJA — Ku shkon?
- MITI — Do vete t'i shkul mjekrën.
- PIRROJA — Hë! Po të mbarohej puna me një mjekër prifti...
- MARGA — Po ti nga humbe?!... Miti më pati thënë se pate qenë burgjeve.
- PIRROJA — Po, në Gjirokastër!
- PALI — Thonë se kush vdes atje nuk e nxjerrin, po e hedhin në pus të kështjellës.
- PIRROJA — Hedhin dhe të gjallë.
- PALI — Doemos, komunistët.
- KOLI — Mirë, mirë... Ti, shyqyr, mirë qenke! Më pati marrë malli, të them të drejtën. Një nipi im më tregonte se nga burgjet, me ato që punojnë, kanë dalë dhe të çmendur.
- PIRROJA — Po, bie era dhé, koskat të përkulen nga lagështia dhe, po nuk qëndrove, të thyhet shpirti. Të tillë ka, po unë kam njohur dhe shumë të tjerë dhe këta nuk janë pak si brenda dhe jashtë burgjeve... Ç'më vështron, nënë Marga!
- MARGA — Dashkam të të dëgjoj.
- MITI — *(Të tjerëve)* Dukuni sonte nga shtëpia të bisedojmë.
- PIRROJA — Po këndeje si i keni punët?
- NDREU — Ç'e pyet! E ngritën dhe taksën e kripës, se edhe ajo kishte mbetur pa u ngritur. Dru në pyll nuk na lënë të presim, se thonë se e ka blerë një shoqëri e huaj të çajë dërrasa...
- KOLI — Po vjen Dani!
- DANI — Më thanë se ka ardhur Miti. Do vete, thashë, të pyes djalin e mikut tim, se kam ndër mend ta lë fshatin.
- PALI — Edhe ti? Pse?
- DANI — Mbetëm duke u lutur... Mirë e ka Marga, zoti

nuk hedh misër. Ndërsa puna e qeverisë, them të jetë ndryshe! Apo jo?

MITI — Ti ishe kur e mallëkuan nënën?

DANI — Isha, isha... Dhe, të drejtën, thashë të të takoja dhe ty dhe Margën.

MITI — Nuk kanë ku më shkojnë, jo, as prifti, as ata që e mësojnë... Edhe sikur në bri të buallit të futen, kam për t'i gjetur.

DANI — Ç'të bësh, thuaj!... Po ky shoku?

MARGA — Është kallajxhi.

MITI — E takova në rrugë. Më kishte thënë nëna dhe ia prura.

NDREU — Si të mbarosh ti, Margë, do ta marr unë.

MITI — Kam për t'i dhënë vaj recini priftit.

DANI — Kokë si ajo... atë feste do!

AKTI I TRETË

Tabloja e parë

(Në një tabelë dërrase është shkruar pa kujdes:
«Rruga Mbretnore»)

K O R I

«Mallëkuar qoftë mbreti, mallëkuar qoftë beu,
hostenin na e theu dhe truallin na rrëmbeu,
braktisëm ne vatanin, se fusha s'na ushqeu!..»

OFICERI — Pse nuk filloni punën?

MITI — Se kërkesat tona nuk janë marrë parasysh.

OFICERI — Flas për ata që kanë ardhur këtu për halle...
Për të fundit herë urdhërojmë të dilni në punë dhe
t'i kërkonti falje sipërmarrësit të huaj për kohën e
humbur!

MITI — Kësaj i thonë të vijë tjetri në shtëpi të të... dhe
ti t'i thuash të falemnderit.

KAPTERI — Mos luani me zemërgjanësinë e qeverisë
nanë!

OFICERI — Në kanë fëmijë dhe gra, të mendohen, kap-
ter! Do të ketë dhe këtu të arsyeshëm, që nuk ka
ç'iu duhet politika komuniste... (Dalin)

KOLI — Perëndia dhe qeveria...

- LAMI — Një djall e gjysmë! Të lënë pa bukë.
- DANI — Kështu është, kur lakmon copën e madhe, humbet dhe kafshatën...
- MITI — (*Loli merr kazmën.*) Lëre kazmën!
- LOLI — Nuk është jotja, është imja!
(*Dani qesh*)
- PALI — Pse qesh ti?
- DANI — Nuk e dëgjon ç'thotë ai?! «Është kazma ime.» Sikur ia mori kush.
- PALI — Nuk ia mori, po ti ia dhe.
- DANI — Unë?! Je në vete ti?! Nuk po dinë më njerëzit se ç'flasin.
- HILLI — (*Merr kazmën*) Me këtë kemi lidhur jetën.
- MITI — Dhe ajo ka për të ta ngrënë kokën.
- KOLI — Në mos e pastë mbi supe, po!
- MITI — Dhe krimbi e ka një kokë, po tërhiqet zvarrë duke ngrënë dhe... Dhe ne kështu jemi bërë si krimbi. Po e shtyve jetën me frikë dhë ke për të ngrënë e të rroftë koka që ke mbi supe, pastaj... Paske kokë ti!
- LOLI — Pse mos ke ti?! Ai të thotë «kthehuni në punë» e ti... Cilin të dëgjojmë? Në të është mbushur ty qypi, ne nuk kemi ardhur këtu të blejmë trimërinë tënde.
- MITI — E po shko pas atij, që kur del natën jashtë, zgjon gruan...
- DANI — Dëgjo, Miti! Nuk ta kam për borxh këtë... As të tjerët nuk ta kanë, nëse ti kërkon të mbytësh veten me duart e tua... Oj, nuk e sheh ti?!
- HILLI — Xhandarët përreth...
- LOLI — Një pllakë të varin në qafë dhe të degdisin pra pa diellit...
- KOLI — Dhe rrokullisu në pluhur, si gomerët, për të kruajtur plagët.

LOLI — Nuk e di në e ka me gjithë mend Ndreu, po nga kazma e tij pret e shoqja uloke... Presin dhe dy kalamanjtë.

MITI — Po me Ndreun ç'ke?

PALI — Kujton mos po shpëton veten, po të mbysë edhe atë.

NDREU — Ai nuk shtoi gjë, tha të vërtetën.

MITI — Po ai po tradhton shokët, Ndreu?!

NDREU — Thua ti.

KOLI — Sikur u tha që kompanitë e tjera filluan punë.
(*Merr kazmën.*)

MITI — Edhe ti?! Po ai të gënjen, o Koli! Pirroja është atje, te shokët.

HILLI — Gënjen, nuk gënjen, secili sheh shoshën e vet. Dhe Pirros nuk ka ç'i duhet llogaria e të tjerëve.

LOLI — (*Danit*) Nuk do të ishte keq, sikur të bisedoje dhe një herë... Je kapo.

MITI — Atëherë keni për të parë se sa kushton një kapo.

KOLI — More, ti nuk je në vete!

MITI — Le ta provojë.

DANI — Secili kazmën dhe kokën e ka të vetën: kapterin e patë xhandarët përreth...

NDREU — Bukur!

KOLI — Mirë, thotë. Pushkë nuk ka dhe sille nga sille, xhandarët përpara.

LOLI — (*Lamit*) Po ti?

LAMI — Mua më pyete?!... Zgjidhe ti se je më i mençëm!

KOLI — Nuk e zgjidh dot se... Kape kazmën! E kanë lidhur me nyje të fortë. (*Lami instiktivisht kap kazmën*)

MITI — Lami!

LAMI — (*Hedh kazmën*) Ta marrë djalli, ta marrë!

PALI — Shumë e zgjatëm.

- DANI — Po! Ai, oficeri, mund të vijë!
- LAMI — Djalli ta marrë dhe atë!
- LOLI — Veri gishtin kokës më parë! Je i rrethuar.
- HILLI — Për të ikur, nuk ikën dot.
- MITI — Prisni ju! Lëreni të qetë, se i morët frymën!
- LAMI — Në djallë të veni të gjithë!
- DANI — Prapë nga rrethimi nuk del...
- LAMI — Mirë, pra, e mora vesh! (Mitit) Po ti si thua?
- MITI — Pyet më mirë Ndreun.
- NDREU — Edhe sikur të kthehesh edhe sikur të mos kthesh, prapë nga rrethimi nuk del dot.
- PALI — Atëherë?...
- DANI — Gabimi kushton.
- NDREU — Dhe frika kushton.
- KOLI — Një grosh — një kokë! Sa për të qeshur!
- PALI — Dhe kaq ka për të kushtuar gjithë jetën, po nuk guxuam.
- HILLI — *(Tek sheh Pirron që po vjen)* Kemi fëmijë, Pirro!
- PIRROJA — Kompanitë e tjera janë me ne.
- LOLI — E ç'punë kanë kompanitë e tjera me ne?! Unë fëmijët nuk ia bëj kurban kujt.
- PIRROJA — Megjithatë po ia bënë kurban shoqërisë së huaj. As bukën tënde nuk po e nxjerr dot, mendo më...
- KOLI — Fëmija të ha kokën.
- DANI — Prandaj, duket, Pirroja e ka më të lehtë, se nuk ka fëmijë.
- PIRROJA — Ti e ke dhe më të lehtë, se i ushqen fëmijët dhe në mos gjetsh punë këtu, ndërsa shokët e tu... Ja, Lami nuk mundi të krijojë familje se që lypës... Iu lut ai zotit, beut, mbretit...
- LAMI — Dhe dreqit, thuaj! Aq sa nuk dua të lyp më.
- PIRROJA — Kështu, pra, po humbasim veten për lëmo-

shë, të gjithë po e humbasim, si pa e kuptuar... A e di ku i ke fëmijët ti, Hill?

HILLI — Në shtëpi.

PIRROJA — Pse gënjen?! Ti vetë më ke thënë se, në u kthefsh, nuk di ku t'i gjesh, se gjithë jetën ke mbetur pa një truall...

HILLI — Im atë nuk më la gjë. Duket dhe unë fëmijëve... Kështu qenka kurdisur kjo jeta ime, me shqelmin në zverk!

LOLI — Ata po vijnë.

PIRROJA — Hiqe, pra, shqelmin, fëmijëve mos u shtjer frikë për të jetuar... Po, o Loli, ata do të vijnë.

HILLI — Dreqi t'i marrë të gjithë, se po na luajnë mendsh!

DANI — Domethënë ti je kundër?

HILLI — Dreqi t'i marrë, thashë!.. Ata dhe fëmijët e mi! (*Hedh kazmën*) Na sëmurën nga trutë, na sëmuren!.. Po na dhemb koka.

NDREU — Mos e truaj pjellën, Hilli, se është gjynah!

PIRROJA — Hm!... Gjynah, the Ndreu?!

NDREU — Pse, si t'u duk ty?

PIRROJA — Ke pjellë ti?

NDREU — Po ti, nuk ke turp që ma përmend?

PIRROJA — Jo, po... se po na mbahesh si gjyhnaqar i madh.

NDREU — Po! Se nuk kam vetëm kokën time që, dhe në e lënça, nuk ka kush më qanë... Ti, mundet!

PALI — Fol mbarë, Ndreu! Dhe në e lëntë ai, për fëmijët tanë do ta lërë...

NDREU — Nuk ia kërkoi njeri... Ndërsa ty, aq të bën: kobure e ke pasur mendjen ti, gjithë jetën! Kaçak e grise dhe nuk u shtrove që nuk u shtrove një herë me fëmijën.

PIRROJA — Ai nuk e mori për qejf koburen.

NDREU — (*Tregon kazmën*) Dhe unë nuk e mora për qejf këtë.

LOLI — Dhe po ua bëjmë harram fëmijëve atë të shkretë kafshatë.

MITI — Po ua hap gojën, thuaj, me atë të shkretë kazmë.

NDREU — Dëgjo, ore djalë! Vëri fre asaj goje, se e sheh ti, pastaj, kush është ai tradhtari!

MITI — Dhe ashtu ke për të vdekur ti, tradhtar i fëmijëve të tu... Bashkë me shokët!

NDREU — Po ta marrim vesh një herë! Trimërinë e tyt eti apo të Margës kërkon të shesësh ti?!

MITI — (*Kërcënon*) Merre, pra, kazmën dhe shko e falju italianit!

PIRROJA — Lëre, Miti!

PALI — Çfarë lëre, more! Të ndjek i biri i botës deri në një farë vendi dhe, kur e ndien veten ngushtë, të kthen krahët... Rrezik të të vrasë ndonjë ditë, pa le!

PIRROJA — Nuk vret ai që ka frikë të truaj zotin, jo! Ai më mirë ha thonjtë e vet, se sa të ngrëjë dorë kundër fatit...

NDREU — A po na lë rehat tani, se nuk ta kemi ngenë? Pak se kemi hallet tona, po duhesh dhe ti...

PIRROJA — Dhe dy groshë të qelbura nuk po ua nis dot fëmijëve.

NDREU — Të dija me mend.

DANI — Domethënë ti, Ndreu, je kundër?

NDREU — Ik, ore ti! Dashke të dish ti jam apo nuk jam kundër unë!

LOLI — Ata po vijnë.

PIRROJA — Dilu përpara bashkë me Danin.

DANI — Sekush për vete.

LAMI — Dani për të gjithë.

LOLI — Kujdes gjuhën ti!

PIRROJA — Po, o Loli, po! Dhe Dani për vete... Më ke thënë një herë, o Koli, se pate marrë vesh që nga burgjet dilnin dhe të çmendur.

KOLI — Po!

PIRROJA — E pra, dije se dhe ne këtu jemi të çmendurit e vetes, kur nuk kuptojmë se ç'duhet bërë... Ja, në të urdhërofshin ty të hapësh varrin tim, ç'do të bësh?

KOLI — Nuk e hap.

PIRROJA — Po të detyruan?

KOLI — ...

PIRROJA — E sheh, pra, se je i çmenduri i vetes, përdërisa bën atë që nuk do të bësh?!

DANI — Në se është puna për një varr, kudo mund ta gjesh.

PIRROJA — E dëgjon?! Mos ua lër të tjerëve, Koli! Gërmoma më të thellë se pusi i kështjellës që të pata thënë, se unë jam komunist. Ky e di...

DANI — Unë shikoj punën time.

PIRROJA — Dhe në mos më hedhtë ty, hidhmë ti me Ndreun e Lolin.

LOLI — Ai erdhi! (*Hilli merr kazmën*)

DANI — Djalë, mblihd veten! Tri herë më ke marrë nëpër gojë!. Turp të kesh! Dhe, në do të dish, për çështje patriotike ti vjen pas meje...

KAPTERI — (*Ka hyrë*) Kapoja, në mbledhje! (*Kalon*)

DANI — Ç'farë t'u them?

MITI — Atë që i thamë oficerit.

DANI — Mirë, mirë! (*Del*)

HILLI — Taksiratet tona janë këto, të gjitha.

LOLI — Lëre, po e kërkojmë si breshka gozhdën!...

Tabloja e dytë

(Tek shohin Margën që vjën, çohen ta presin)

LAMI — Po vjen nënë Marga!

MARGA — Gjallë jeni?

KOLI — Gjallë e pa kallur!

PIRROJA — Mirë se erdhe!

MITI — Po ti?!

MARGA — Mora vesh se do t'ju vrasin, prandaj...

LOLI — Ashtu është. Po nuk u kthjem në punë, në mos me plumb, me bukë.

MARGA — Nuk keni vjedhur ju?!

PIRROJA — Ne po na vjedhin.

MARGA — Një që priste dru kësaj ane kishte thënë në pazar se u rrahin nga tri herë në ditë, se keni vjedhur shoqërinë.

LAMI — Bukur sa s'bëhet më! Ata vidh e ne merr nam.

MARGA — Te porta dëgjova se do të vijë dhe një nga qeveria.

HILLI — Po tjetër, Margë?

MARGA — Një koroboc me mustaqe tha se e prisnin... Kishin vënë dhe një flamur në hyrje.

KOLI — Po kjo paska marrë thellë, ç'thoni ju?!

LAMI — Me flamur, si në festë! Hajt, ore hajt!

MITI — Po ty si të lanë?!

MARGA — E gjeta dhe unë një shteg.

MITI — Po mirë, nënë, ja na pe... Shëndoshë si molla jemi. Rruga është e largët, prandaj... Se mos vijnë dhe ata e të gjejnë këtu.

MARGA — Po unë nuk erdha për të ikur, o bir! Dhe as i kërkova njeriu leje që ta kem frikë.

PIRROJA — Po ti mos ki merak, nënë!

MARGA — Fëmija është jeta e prindit.

KOLI — Po vjen oficeri me një tjetër, po vjen!

OFICERI — Zoti përfaqësues i qeverisë ka ardhur t'ju njoftojë vendimin e më të mëdhenjve... Po ti, o plakë?

MARGA — Kapërceva gardhin dhe hyra.

MITI — Është nëna ime.

OFICERI — Mirë, mirë!.. Tani nuk kemi punë me nënën, prandaj...

MARGA — As unë nuk të prish punë ty, zoti oficer, po të rri.

OFICERI — Kapter! (*I bën shenjë ta largojë.*)

MITI — (*Në gatishmëri*) Dëgjo, kapter! Mua më është mërzitur jeta e po të është mërzitur dhe ty, preke!

PËRFAQËSUESI — Lëreni, të qëndrojë, s'ka gjë!... Qeveria shqiptare i kërkoi falje qeverisë italiane, prandaj dhe ti, plakë, nuk ke përse të shqetësohesh... Ja edhe këta tani do të kthehen në punë.

PIRROJA — E përse i kërkoi falje?

PËRFAQËSUESI — Sigurisht, për sjelljen e papëlqyeshme të disave.

MITI — Kush deshi të merrej vesh me qeverinë, le të shkojë!

PALI — E Ndreu?... T'u hap rruga.

NDREU — Nuk marr dorë te ti unë, jo!

PALI — Jo tek unë, jo! Te ai i qeverisë.

NDREU — Pse ç'më kujton ti?!

PIRROJA — Ne nuk kthehemi në punë!

PËRFAQËSUESI — Pse?

PIRROJA — Jeni njohur me kërkesat tona për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të punës?

PËRFAQËSUESI — Më vonë do t'i shikojë një komision qeveritar.

PIRROJA — E po këtë radhë e ka të vështirë ai komisi-

oni qeveritar të na kthejë në punë që sot. Pa u plotësuar kërkesat...

PËRFAQËSUESI — Unë jam përfaqësuesi i qeverisë...

MARGA — Qofsh shëndoshë! Unë jam Marga.

PËRFAQËSUESI — Marga?!

MARGA — E!... As më njeh, as të njoh, po këtyre u janë zbrërthyer brinjët në këtë rrugë. Loli ka tre fëmijë, e di unë. Hilli po ashtu. Te këta i kanë sytë ata. Duan të hanë.

PIRROJA — Dhe ne, në tre vahtet, bukë e supë hamë. Dhe kjo supa e jonë, zotërinj, është ujë përroi i nxehur.

PËRFAQËSUESI — Sigurisht, këtu nuk thoni të vërtetën.

PIRROJA — Ja tek janë shokët, pyeti!... Ashtu të uritur e të lodhur mblihdemi me nga një copë batanije të vjetër, për t'i ruajtur ato tre groshë të flamosura dhe, megjithat, ju e kuptoni...

PËRFAQËSUESI — Fol më parë për vete.

PALI — Po nuk dalin, more zotëri, nuk dalin as për të mbajtur frymën, ta marrë djalli, ta marrë, jo më për fëmijët e mi apo të atij.

PIRROJA — Ja, Ndreu... Gruan e ka uloke.

NDREU — Po pse, mos të ka mbetur në derë ime shoqe ty, Pirro..

PIRROJA — Kupton apo nuk do të më kuptosh?

PËRFAQËSUESI — E sheh që duhet të flasësh për vete më parë?! Ja njeriu i ndershëm, që ti po e bezdis duke folur për të!

MARGA — E po, kasollet tona në një vend pikojnë, o i qeverisë.. ...Dhe ty të lumtë, o Ndreu, pështyve shokun përpara tij!

PËRFAQËSUESI — Lëreni atë! Ai mendon për vete, për gruan, për fëmijët..

NDREU — Prit, o i qeverisë, prit, se më paske marrë vesh keq. Nuk desha të ma përmend gruan, ta marrë djalli, ta marrë. Sikur ime shoqe qenka fatkeqësia e këtij vendi... E di që e kam uloke dhe sa më dhemb, unë e di, po plagën nuk dua të ma lëndojë njeri... Prandaj desha dhe të mos ma përmend... Dhe mos kujto ti se unë jam shoku i atij!
(Lolit)

LOLI — Nuk e kam lënë veten në dorën tënde unë, jo!

PIRROJA — Po, o Loli, e ke lënë në dorë të zotërinjve... Nuk po dimë kush jemi... E, pra, punojmë sa ka ditë, po nuk na jepet munda, na vidhet.

PËRFAQËSUESI — Si?!

PIRROJA — Po vidhni me të dyja duart, zotëri! Eh, ju jeni më të prapë se hajdutët: hajduti nuk e jep gjënë e vjedhur, po ju e mbronin dhe me armë. Qeveri hajdute, që nga ministrat...

PËRFAQËSUESI — Arrestojeni!

KAPTERI — *(I bie bilibilit. Shokët me Margën i dalin në mbrojtje)*

— Të tjerët largohuni!

MARGA — Ç'ke për të bërë, bëje! Pushka top t'u bëftë!

PËRFAQËSUESI — Lidhi!

OFICERI — Lidhi, kapter!

(Marga nisat drejt përfaqësuesit. Miti kap kazmën, ndihet kënga «Ne thyejmë gurë...»)

PIRROJA — Të tjerët janë me ne.

MITI — Kujdes, vëllezër! Ruhuni, gushkuqa!...
(Çoroditje)

AKTI I KATËRT

Tabloja e parë

(Tellalli shoqëron parinë për tek Aldua, në festimin e Ditës perandorake)

TELLALLI — Për hirë të zotit dhe me vullnet të kombit, më në fund perandori i Etiopisë, mbreti i Italisë dhe i Shqipërisë, Viktor Emanueli III u detyrua të pranojë lutjen e popullit shqiptar për të mbajtur mbi krye kurorën e Skënderbeut.

...Ej, millet! Sot në mëngjes, zonja e princit trashëgimtar të fronit perandorak, princesha e Piemontit; lumturisht nxori në dritë një femër... Për gëzim të popullit shqiptar dhe të popullit italian femra peshon katër kile dhe është mirë me shëndet. Marie! — kështu do të quhet femra... Ministri i Arsimit, nga gëzimi i kësaj dite, urdhëroi të mbyllen shkollat... Të gjithë zogjtë e shqipes dykrenare dhe këlyshët e ulkonjës italiane, që lindën këtë ditë, kanë fatin të jenë moshatarë me Marien; që në orën 8, në Romë kërkërcet topi dhe në Tiranë kërcet kob... kërcet daullja...

...Kush dëshiron të veshë këmishën e zezë, le të vrapojë të tërheqë mandatin nga zyrat e fashios, ose komunalja.

QEMALI — Zoti Aldo! Ekselencë! Në këtë ditë gëzimi ne kemi hequr nga brezi i të parëve tanë këtë kobure, për t'ua dhënë juve ta vini në brezin e Italisë së madhe. Dita, njëmijë!

(Ndiheh kambana)

ALDO — Këmbanat?!

PRIFTI — Në këtë ditë të shënuar besimtarët...

QEMALI — Kanë rënë në gjunjë, bëjnë dua dhe ndajnë meshë...

ALDO — Ndajnë meshë?!

PRIFTI — Më falni! Zoti Qemal e ngatërroi: një ceremoni, ku besimtarët luten.

ALDO — Ju falënderojmë për këtë dhuratë!... Dikur mbreti i Napolit kërkoi dorën e Skënderbeut për të mundur armiqtë e vet. Skënderbeu me bujari i vajti në ndihmë dhe fitoi... Kur Skënderbeu kërkoi ndihmë, vetë Papa Kalisto III e mbështeti, duke i dhënë bekimin «Atlet i Krishtit!»... Në prillin e luleve populli shqiptar iu lut Duçes për ndihmë. Duçja i solli popullit shqiptar pranverën fashiste... Momenti e kërkon që këtë kobure ta zbrazim së bashku kundër Partisë Komuniste, që kërkon të shkelë mbi këto lidhje fisnike... Ju falënderoj! Do t'ju lutem, zoti Qemal dhe hirësia e tij, të qëndrojnë pak!

(Përcjell të ardhurit)

PRIFTI — Kokë e madhe duket!

QEMALI — E kanë dekoruar me kryqin e hekurt.

PRIFTI — Si fetar?!

QEMALI — Jo, si luftëtar. Tani le të guxojnë komu-

nistët të vështrojnë fashizmin në sy. Ai ka për t'i përpirë të gjithë.

PRIFTI — Dhëntë zoti!

ALDO — (Vjen) Po!... Në krye të qytetit është një portret i madh i Duçes. Nën të një shkëlqim të veçantë jep diviza «Kredere!», «Obedire!», «Kombatere!» dhe «Vinqeremo!»... E rrethuar me drita kjo pamje shkëlqen, sa fillon e bie nata.

PRIFTI — Me të vërtetë gjë e bukur, zoti Aldo! E bukur! Duket që nga fshatrat larg, zoti Aldo! Unë i kam parë fshatarët majë kodrave që sodisin me kënaqësi.

QEMALI — Diçka e rrallë, që e bën qytetin tonë modern dhe e ndien veten sikur je në Evropë, në Itali... Dhe mund të themi se kjo është një ndër veprat me vlerë të qytetit tonë, se i jep një shkëlqim të veçantë...

PRIFTI — Rreth figurës këto drita ngjajnë si kurorë shenjtë.

ALDO — Po, po!... Po nga pamja madhështore mbrëmë ka mbetur vetëm portreti i Duçes dhe poshtë tre gërma me drita «VIÇ».

PRIFTI — Viç?!

QEMALI — Viç, thatë?!

ALDO — Ç'do të thotë viç?!

QEMALI — Është një... një...

ALDO — Çfarë një... një...

PRIFTI — Kafshë me brirë, zotëri...

ALDO — Ç'do të thotë «viç» nën portretin e Duçes?! Këtë pyes... A nuk është më e drejtë të mendohet se tërë qyteti mbrëmë vështronte portretin e madh dhe përsëriste nën zë: «viç!», «viç!» sa herë që ndizeshin e shuheshin ato gërma të mallëkuara? Madhëria fashiste, që shpreson një botë, përfundoi këtu në viç!

QEMALI — Turp! (*Prihti bën kryq.*)

ALDO — Po, hirësi! Për të bërë kryq është! Çfarë t'i them məkëmbësit?!

QEMALI — Mos është ndonjë difekt, zoti Aldo!

ALDO — Po pse nuk ndodhi në pjesën tjetër të divizës?! Dhe pse pikërisht te «Vinçeremo»?! Dhe pse nuk mbeti, ta marrë djalli!, «vinç», po «viç»?!... Të mos i thjeshtojmë gjërat, zoti Qemal! Kjo sigurisht nuk mund ta ulë vlerën e punës fisnike të Italisë për Shqipërinë, që e nxori nga jeta rebele e çetave dhe i mësoi shqiptarit nocionin ç'do të thotë shqiptar modern... Po ju sot me këtë koburë duhet të më kishit sjellë dhe bindjen fashiste popullore.

QEMALI — Ne jemi përpjekur që qarku ynë ta veshë me entuziazëm këmishën e zezë. Aq është e vërtetë kjo, sa qarkullojnë fjalë rreth personit tim, rreth familjes sime. Vajzës sime, sinjorinë Mahmudesë, i këndojnë këngën e putankës, që harbon me italianët...

ALDO — Duhet të na shqetësojë dhe jeta e besimtarëve, hirësi.

PRIFTI — Lutën, zoti Aldo! Ne përpiqemi që Duçen e madh ta vemë krah ikonës, për kujdesin prindëror që tregoi për fëmijët tanë, që i mori e i çoi në Itali... Mundohemi të shpjegojmë se midis feve tona, ortodokse e katolike, nuk ka asgjë të ndarë. Ato i bashkon një Krisht. Po ka dhe gojë të liga, zoti Aldo! Antikrishtët janë të mallëkuar... Dhe nga veza e gjarpërit, gjarpër do të lindë!

QEMALI — Uratë!

PRIFTI — S'ka! E ka thënë Jezui. Ai është i çmendur.

ALDO — Kush?!

QEMALI — Mos e ke për...

PRIFTI — Po! Më thanë se kanë parë dhe Margën këtu.

QEMALI — Ëhë!... E ka fjalën për të arrestuarin.

ALDO — Marga mos është ajo gruaja që më ke folur,
zoti Qemal!

PRIFTI — Një e çmendur është, me kobure...

QEMALI — Po!

PRIFTI — Ku ta dish, mos ka ardhur të çlirojë të birin.

QEMALI — Nuk është i biri, është Pirroja.

PRIFTI — Bir për shpirt e ka dhe atë, e mallëkuara.
Ata po të çmendur janë të dy...

ALDO — Nuk po ju kuptoj, zotërinj! Dhe për atë kobure që u ngrit kundër perandorit, kur erdhi në Shqipëri thanë se qe e një të çmenduri... Dhe për ata që prenë linjat telefonike në të gjithë Shqipërinë, thanë se qenë kalamanj... Tani edhe ky?! Po të dhënat tuaja janë, zoti Qemal, se kur ka qenë ky në fabrikë të miellit është vjedhur miell me makina.

PRIFTI — O zot i madh! Çfarë nuk bëjnë të paudhët!

ALDO — Ku shkojmë, zotërinj?!... Tre ushtarë italianë kthehen në repart të dehur. Dhe të dehur dhe të çarmatosur: ku kanë pirë, nuk mbajnë mend... Matanë lumit janë hedhur armë të ngarkuara në qerre me dega dushku. A e kuptoni se ç'po bëhet?! Nga depot tona po vidhen armë. Në shtëpinë gërmadhë, ku natën gjoja lëviznin lugetër, në të vërtetë mblidheshin komunistët. Ky në burg — portreti i Duçes «viç!» ...E po mos doni t'ju paraqes një arshivë me fakte dhe dokumente?! Më parë të zhvishemi nga fantazitë, zotërinj. Nuk është fantazi as komunizmi, as fashizmi. Ata janë dy kundërshtarë që jetojnë për vdekje të njëri tjetrit!..

Tabloja e dytë

(Sjellin Pirron. Dani gardian.)

ALDO — Ja, zotërinj! Arriti të shkelë dhe mbi kufijtë e arsyës... U ngrit dhe kundër fashizmit që jep shenjë e qytetërimit në botë.

PIRROJA — Pushtimi imperialist qytetërim?! Lirinë e të tjerëve ju e quani pronë, sundimin e të tjerëve-kulturë?!..

ALDO — Komunizmi është i paskrupull, zotërinj! Luftën për të shembur ligjet e një rendi të vjetër e quan pushtim dhe harron se fashizmi nuk mund të presë zgjimin e kombeve.

PIRROJA — Fashizmi këtu erdhi si një murtajë, ndërsa komunizmi lindi në këtë truall si një nevojë në jetën e këtij populli... Edhe po vdiqa unë, komunizmi përsëri do të mbetet.

QEMALI — E kam paralajmëruar të mos hedhë gurë në sarajtin tim.

PIRROJA — Dhe Qemal beu nuk do të kthehet më në sarajet e veta, as kur të vdes unë... Ndërsa ju, zoti Aldo, do të kërkoni kokallat tuaja këndeje. Atëherë keni për t'u bindur se sa e thellë është kjo tokë dhe se ky popull nuk pranon satrap e viça mbi krye!

QEMALI — Viç, the?!

(Aldo qëllon me kobure. Pirroja mbetet në këmbë)

PRIFTI — O zot i madh!

EPILOGU

(Përcjellja nga kasollja)

NERËNXA — Do të shkosh?

MITI — Presim më parë nënën... Ti e gatite torbën!

NERËNXA — Nuk e di si më duket.

MITI — Pse?!

NERËNXA — ... Djali do të rritet.

MITI — Do të rritet.

NERËNXA — Unë do t'i këndojë për ty.

MITI — Unë do të kthehem.

NERËNXA — Do t'i tregojë për ty, desha të them.

MITI — Do t'i tregoj vetë... Ne do të lindim përsëri.

(Vjen Marga) Erdhe, nënë?

MARGA — (I jep një letër) Merre!

MITI — (Si e lexon) Mbrëmë ndodhi?

MARGA — Mbet në këmbë, si lisi i goditur nga rrufetë.

MITI — Tjetër gjë të thanë shokët?

MARGA — Jo!... Ti ke plumb?

MITI — Kam, po nuk mundem... Merr vesh?!

MARGA — Qenke bërë i matur!

NERËNXA — Ata nuk janë më fëmijë, nënë.

MARGA — Për ju gratë, po! Për nënat fëmijë do të mbeten gjithë jetën... Marinës mos i thoni gjë.

MITI — Ti kujton se e kam të lehtë?! Unë jam rritur me të dhe, po të më thonin, nuk do ta kurseja veten... Po ta marrë djalli, ta marrë!... Nuk e kam në kokën time. Ja, këtë desha të them.

MARGA — (Tek sheh Marinën) Tani erdhe?

MARINA — Burrat po mblidhen te sheshi.

MITI — (Në të dalë) Gatitma torbën!

MARGA — Pritmë këtu Marinë! (Del)

MARINA — Pse thërriste dajë Miti?

NERËNXA — E shau nëna, seç i tha...

MARINA — Çfarë?

NERËNXA — Nuk e di... Do të bëhet luftë e madhe, Marinë.

MARINA — Për vdekje, thonë.

NERËNXA — Kur do të nisen?

MARINA — Nuk e di.

NERËNXA — Për Lenën thonë se ka ngjeshur gjerdanin e të shoqit.

MARINA — Dëgjova... Dhe e bija e Kristos do të iki.

NERËNXA — Ti mos shko, Marinë! Rrimë të dyja.

MARINA — Ç'thua dajë Miti?

NERËNXA — Asgjë!

MARINA — Po tjetër ç'tha nënë Marga?

NERËNXA — Po... Nuk e di!... Janë ngritur burra dhe gra.

MARINA — Edhe ata që nuk kanë marrë pushkën, në luftë janë.

NERËNXA — Në luftë?!

MARINA — Dhe ti rrit fëmijë.

MARGA — (Në të hyrë) Nuse!

NERËNXA — Uh, duhet të bëj gati plaçkat! (Kalon)

MARGA — Bijë e nënës!

MARINA — Në burg e kanë?

MARGA — Jo!... Mos deshe të shkosh dhe ti me Mitin?

MARINA — Sa e mirë që je!

MITI — Do ta lësh vetëm?!

(Ndërkohë kalon vargu i grupit, që do të niset partizan)

MARGA — Marinë!... Sillja nënës një kapele të hekurt, se dua t'u jap ujë pulave...

F u n d